



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI I KOMUNËS PEJË**

**I. Numër: 400-01/83731, datë: 29 Tetor 2024**

Në bazë të nenit 11, nenit 12. paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe nenit 24. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L – 049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431, dt. 30 Shtator 2020, Kuvendi i Komunës së Pejës, në takimin e mbajtur me datë: 29 Tetor 2024, më rekomandim të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe propozim të kryetarit të Komunës, merr:

**VENDIMI**

**Nr. 59/2024**

**për faljen e borxheve të pa paguara për taksën në aktivitet (afariste) në Komunën e Pejës**

1. **MIRATOHET** falja e borxheve të pa paguara për taksën në aktivitet (afariste) për të gjithë taksapaguesit (subjektet afariste) e Komunës së Pejës nga data 01.01.2002 deri me datën 31.12.2013
2. Më këtë vendim shlyhen nga evidenca e borxheve të papaguara për taksën në aktivitet (afariste) të gjitha borxhet e taksapaguesve (subjektet afariste), përfitues nga periudha e cekur në pikën 1 të këtij vendimi nga zyrtarët përgjegjës në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, Komuna Pejë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Pejës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përkatëse për qeverisje lokale si dhe 7 (shtat) ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi ti dërgohet:**

MAPL,  
Kryetarit të Komunës,  
DZHE,  
DBF,  
Arkivës.



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Z. Rexhep Kurtbogaj**